



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.16, datë 20.02.2017

**“PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2015”**

Në mbështetje të nenit 44, nenit 54, nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 7776 datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.6.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 23.12.2014 për “ Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 25 datë 13.08.2015 për “Një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” në zbatim të reformës së re administrative territoriale”Urdhërësës Nr.80 datë 28.01.2013 për “Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë treguesit e realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015 sipas relacionit dhe pasqyrave nr.1, 2, 3, dhe nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI